



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Seanca plenare**

Seanca nr. 02-26/13-06

Prishtinë, më 15 qershor 2006

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën në fillim e kryesoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë, kurse pjesën e dytë e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

**Kryesuesi** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 73 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtaritë hidrometeorologjike;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për efikasitetin e energjisë;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin në Ligjin nr.2004/12 për standardizim;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për raportimet financiare të ndërmarrjeve;
8. Përgjigjja e kryeministrit për interpelancë lidhur me Ligjin për vlerat e luftës së UÇK-së;
9. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të pestë në Këshillin e KPM-së;
10. Shqyrtimi i propozimit për caktimin e kushteve dhe të kriterëve për zgjedhjen e Avokatit të Popullit të Kosovës dhe
11. Koha për pyetje parlamentare.

Në fillim seancën e kryesoi **Sabri Hamiti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

## 1. Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

**Ibush Jonuzi**, kryetar i Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri, kërkoi të hiqet nga rendi i ditës shqyrtimi i dytë i Projektligjit “Për efikasitetin e energjisë”.

**Gani Koci**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, e kundërshtoi propozimin e Ibush Jonuzit.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e Ibush Jonuzit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----45;  
Kundër-----25;  
Abstenime----3.

**Kryesuesi konstatoi:** Shqyrtimi i dytë i Projektligjit “Për efikasitetin e energjisë” hiqet nga rendi i ditës.

**Emrash Xhemajli** (LPK) kërkoi që Kuvendi të bëjë një pauzë derisa të lirohen nga burgu aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosja, në mesin e të cilëve janë edhe veprimtarët: Albin Kurti, Naim Zhitia dhe Liburn Aliu.

**Alush Gashi**, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi që pika 9-të e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës, ngase mungon propozimi dhe biografia e kandidatit për KPM.

**Fshimi Mujota** (PDK) e mbështeti propozimin e Alush Gashit.

**Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kërkoi që Kuvendi të miratojë Rregulloren për emërimin e anëtarëve të Këshillit të KPM, me të cilën duhet ruajtur baraspeshën ndërmjet pozitës dhe opozitës.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin për heqjen e pikës së 9-të nga rendi i ditës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;  
Kundër-----0.

**Kryesuesi konstatoi:** Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të pestë në Këshillin e KPM-së hiqet nga rendi i ditës së seancës së sotme.

**Jakup Krasniqi**, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, kërkoi që në rend dite të seancës së sotme të radhitet edhe çështja e arsimit në Kosovë.

**Hydajet Hyseni** (PDK) tha se e mbështet kërkesën e deputetit Emrush Xhemajli, për të cilën kërkoi që Kuvendit të vendos me votim.

**Nekibe Kelmendi** (LDK) kërkoi që Kuvendi ta miratojë një deklaratë, me të cilën kundërshton veprimet e udhëheqësve të tri komunave në veri të Kosovës, që kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme.

**Gani Koci** (PDK) propozoi që të gjithë deputetët e Kuvendit të shkojnë në pjesën veriore të Mitrovicës dhe të njihen nga afër me gjendjen e krijuar atje.

Pas diskutimeve të deputetëve: Alush Gashi, Naim Maloku, Teutë Sahaqija, Ferid Agani, Xhezair Murati dhe Xhavit Haliti Kuvendi i ngarkoi kryetarët e grupeve parlamentare t'i harmonizojnë qëndrimet lidhur me propozimin e deputetes Nekibe Kelmendi.

**Alush Gashi**, në emër të kryetarëve të grupeve parlamentare, paraqiti rekomandimin, si vijon: Kuvendi kërkon nga Kryesia dhe nga Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë të kërkojnë informata zyrtare nga Qeveria e Kosovës, nga UNMIK-u dhe nga KFOR-i, për gjendjen e sigurisë në veri të Kosovës, me të cilën, sa më shpejt, duhet të informohet Kuvendi i Kosovës.

**Kuvendi** miratoi rekomandimin e kryetarëve të grupeve parlamentare.

## **2. Miratimi i procesverbali të seancës plenare të 1 e 2 qershorit 2006**

**Procesverbali** i seancës plenare të 1 dhe 2 qershorit 2006 u miratua pa vërejtje.

Në **transkript** pati vërejtje deputetja **Naxhije Doçi**, ngase nuk ishte evidencuar diskutimi i saj për Projektligjin për arkivat, që e kishte dorëzuar me shkrim. Deputetja **Safete Hadërgjonaj** pati vërejtje, ngase teksti i diskutimit të saj ishte zëvendësuar me diskutimin e deputetes Hatixhe Hoxha.

Kuvendi ngarkoi përgjegjësit e administratës t'i korrigjojnë lëshimet e bëra në transkriptin e seancës plenare të 1 dhe 2 qershorit 2006.

## **3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes**

**Kryesuesi** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit Përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, secilin veç e veç, amendamentet e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7., 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 18.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;  
Kundër----- 1;  
Abstenime-----1.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash miratoi Ligjin kundër shpifjes dhe fyerjes.

Pas kësaj kohe seancën e drejtoi **Kolë BERISHA**, kryetar i Kuvendit.

#### **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike**

**Kryetari** i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votë, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Pastaj kryetari e hodhi në votim Projektligjin dhe amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----67  
Kundër----- 1.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës e **miratoi** Ligjin për veprimtarinë hidrometeorologjike.

#### **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/12 “Për standardizim”.**

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri, **Kadri Kryeziu**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/12 “Për standardizim”.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri, Kadri Kryeziu, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Ibush Jonuzi, Bajrush Xhemajli, Xhevdet Neziraj Mahir Jakxhillar dhe Teutë Sahatqija**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 58;  
Kundër----- 1.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/12 “Për standardizim”.

Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Postë-telekomunikacion - Komision Përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për raportimet financiare të ndërmarrjeve**

**Kryetari** e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendësministri **Behxhet Brajshori**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri, si dhe qëllimin dhe objektivat që do të realizohen me zbatimin e tij.

Në vazhdim, zëvendësministri **Brajshori** shpjegoi strukturën e këtij projektligji, të radhitur në 12 kapituj.

Në fund ai i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë projektligj .

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga zëvendësministri **Brajshori**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij, në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Naser Osmani, Demir Limaj, Mazllun Kumnova, Nazim Jashari, Xhezair Murati, Ramazdan Kelmendi, Ali Sadrija, Gani Koci, Nerxhivane Dauti dhe Nekibe Kelmendi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 68;

Kundër----- 2.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për raportimet financiare të ndërmarrjeve. Kuvendi i ngarkoi komisionet e veçanta dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa - Komision Përgjegjës - raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe t’ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim

## **7. Përgjigjja e kryeministrit të Kosovës për interpelancën e parashtruar nga GP i PDK-së lidhur Ligjin e vlerave të UÇK-së**

**Kryetari** e ftoi kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së për ta arsyetuar kërkesën për interpelancë.

**Jakup Krasniqi**, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se me rastin e shpalljes së Ligjit për vlerat e UÇK-së shumë vetë i kanë keqpërdorur detyrën dhe përgjegjësinë që e kanë. I pari që e ka keqpërdorur detyrën dhe përgjegjësinë që e ka është shefi i UNMIK-ut, i cili e dinë shumë mirë se si procedohet nëpër të gjitha fazat një ligj i miratuar në

Kuvend, dhe i dyti është kryeministri i Kosovës, i cili është përgjegjës për zbatimin e ligjeve, por jo ta japë firmën në një ligj.

Kërkoj nga kryeministri i Kosovës të deklarohet se cilat kanë qenë arsyet e tjera që është bërë ky simulim dhe ky mashtrim i opinionit për nënshkrimin e një ligji ,që edhe ka qenë ndryshuar , jo në atë formën që është miratuar në Parlament. Përveç simulimit dhe mashtrimit, ligji është ndryshuar dhe ndryshimet nuk kanë mund të ndodhin. Në këtë procedurë ka shume shkelje dhe dikush për të gjitha këto shkelje duhet të japë përgjegjësi.

Kryeministri **Agim Çeku** tha - Nga dita e parë e punës sime si kryeministër, në fokus të angazhimeve të mija ka qenë mbrojtja e vlerave të luftës dhe përkujdesja për kategoritë të dala nga lufta. Këtë e kam ndier si obligim institucional, por mbi të gjitha edhe si obligim moral ndaj shokëve dhe ndaj bashkëqytetarëve të mij. I nxitur nga dëshira e madhe dhe qëllimi i mirë, që këtyre kategorive t'u ofrohet sa më shpejt përkujdesja institucionale, kam insistuar te z. Jesen Petersen që të nënshkruhet Ligji për vlerat e luftës, që më parë është miratuar nga ky Kuvend.

Me 2. maj, në zyrën time bashkë me z. Jesen Petersen kemi organizuar një takim për këtë çështje të rëndësishme. Gjatë takimit z. Jesen Petersen më sugjeroi aty për aty dhe insistoi që edhe unë, në prani të mediave, të bëjë një gjest simbolik nënshkrimi edhe pse dihet se nuk është në kompetencën e kryeministrit t'i nënshkruajë ligjet e miratuara në Kuvend.

Për këtë gjest simbolik, unë e kam shprehur dhe shprehi keqardhjen time edhe pse nuk kam bërë ndonjë shkelje ligjore, sepse asgjë nuk është nënshkruar, vetëm është bërë një gjest simbolik se po e nënshkruajmë ligjin.

Gjatë takimit me z. Jesen Petersen kemi pasur përpara vetëm ligjin në formë siç është miratuar në Kuvend dhe kemi qenë të bindur se ai do të nënshkruhet pa asnjë ndryshim.

Dua t' ju siguroj se askush nga ne nuk ka qenë i informuar për ndryshimet terminologjike që janë bërë më vonë në letrën përcjellëse, të cilën e ka hartuar Zyra Ligjore e UNMIK-ut.

Të nesërmen, pasi është kuptuar se janë bërë ndryshime, kemi organizuar një takim të përbashkët me Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale, ku kanë qenë të pranishëm: zëvendës i kryeadministratorit i UNMIK-ut z. Stiven Shup, ministri Selmanaj dhe drejtuesit e të tri shoqatave që i përfaqësojnë vlerat e luftës. Ne ia kemi shprehur mospajtimet tona për këto ndryshime zëvendës kryeadministratorit z. Shup dhe kemi kërkuar prej tij që ligji të pezullohet dhe këto ndryshime të rishqyrtohen. Të njëjtat shqetësime dhe të njëjtin qëndrim ia kam përcjell të nesërmen z. Jesen Petersen dhe jemi pajtuar se kjo çështje të rishqyrtohet dhe ligji të dërgohet edhe një here në Zyrën Ligjore të OKB-së, në Nju Jork. Ligji tanimë është dërguar atje dhe jemi në pritje të një përgjigjeje.

Për mua si kryeministër është i pranueshëm Ligji për vlerat e luftës vetëm në formën siç është miratuar në këtë Kuvend.

Pas përgjigjes së kryeministrit, kryetari e hapi debatin lidhur me të.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë edhe këta deputetë: **Berat Luzha, Naim Maloku, Alush Gashi, Gjergj Dedaj, Sabit Rrahmani, Fatmire Mulhaxha, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Hajredin Hyseni, Gani Koci, Bajrush Xhemajli, Nekibe Kelmendi, Kamber Kamberi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, **Jakup Krasniqi**, në emër të Grupit Parlamentar – parashtrues i interpelancës tha - Z. kryeministër, sinqerisht, më vjen keq që keni gabuar, ose ju kanë shtyrë të gaboni, por më vjen mirë që keni ardhur në Kuvend të përgjigjeni.

Keqardhja, të cilën e shprehni, është për t'u vlerësuar. Grupi Parlamentar i PDK-së e vlerëson këtë gjest. Ajo është garanci që nuk do të përsëriten simulimet në të ardhmen, që mund të jenë me pasoja edhe më të rënda se sa simulimi për nënshkrimin e një ligji.

## **8. Shqyrtimi i propozimit për caktimin e kushteve dhe të kriterëve për zgjedhjen e Avokatit të Popullit**

**Sadudin Berisha**, nënkryetar i Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese, i arsyetoi rregullat e procedurës për emërimin e Avokatit të Popullit, të zëvendësit kryesor të tij dhe të zëvendësve të tjerë, që i kishte hartuar ky komision.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----68;  
Kundër----- 5.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash miratoi rregullat e procedurës për emërimin e Avokatit të Popullit, të zëvendësit kryesor të tij dhe të zëvendësve të tjerë.

## **9. Koha për pyetje parlamentare**

Deputeti **Ferid Agani** pyeti ministrin Haki Shatri lidhur me pagesat e punonjësve shëndetësorë për kohën e kujdestarisë.

Ministri **Shatri** nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigjur deputetit Agani.

Deputeti **Fehmi Mujota** pyeti kryeministrin Agim Çeku për zbatimin Reguloreve të UJNMIK-ut nr. 2001/19 dhe 2001/36 lidhur me sekretarët e përhershëm në ministrinë e Qeverisë së Kosovës.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj deputetit Mujota.

Deputeti Mujota i bëri pyetje shtesë kryeministrit lidhur me raportet ndërmjet stafit politik dhe atij civil.

Kryeministri tha se do të përgjigjet në seancën e ardhshme.

Deputeti **Gazmend Muhaxheri** pyeti kryeministrin lidhur me hartimin e planit strategjik për zhvillimin e Kosovës.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj deputetit Muhaxheri.

Deputeti **Hydajet Hyseni** përsëriti pyetjet e parashtruara më parë për ministrat:

- Ministrin e Pushtetit Lokal, z. Lutfi Haizi, lidhur me shpenzimin e mjeteve për zbutjen e pasojave nga tërmeti në komunën e Gjilanit;
- Ministrin për Komunitete dhe Kthim, Sllavisha Petković, lidhur me gjendjen e të zhvendosurve nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja dhe
- Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lidhur me gjendjen e diasporës së Kosovës në Evropë dhe botë.

Ministrat, të cilëve u ishin parashtruar pyetjet, nuk ishin të pranishëm në seancë.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** pyeti ministrin **Haki Shatri** lidhur me transparencën e punës në Administratën Tatimore të Kosovës.

Ministri, Haki Shatri, nuk ishte i pranishëm në seancë.

**Kryetari** e deklaroi seancën të mbyllur në orën 13:25 minuta.

**Kryetari** i informoi deputetët se kryeministri i Republikës së Shqipërisë, **Sali Berisha**, në orën 15:00 do të mbajë një fjalim para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

E hartoi

**Spektori për Çështje Plenare dhe Procedurale**